



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Vlorë, më 09.10.2018

Nr. 3167 Prot

VENDIM

Nr. 33, Datë 28.09.2018

**PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.**

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 28.09.2018 në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të Kreut IV, pika 26 të VKM – së Nr. 442, datë 18.07.2018 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë e të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991 dhe të truallit funksional të tyre" dhe të VKM - së 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre" i ndryshuar si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Vlorë.

**VENDOSI :**

1. Të miratojë Vendimin Nr.73, datë 06.06.2018 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektin aplikues **Z. Neki Ngucaj (subjekti Z. Neki Ngucaj me gjeneralitetet e subjektit sipas certifikatës së vitit 1991)** për një objekt banimi me sipërfaqe ndërtimi 48.0 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe truall funksional 140.0 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Lagjen "24 Maji" të qytetit të Vlorës, zona kadastrale 8604, Nr. pasurie 7/128 që kufizohet nga Veriu me Fadil Rakipi dhe Rrugën "Prenjo Petoshati", Jugu me Esat Ngucaj, nga Lindja me Kamber Ngucaj dhe nga Perëndimi me Serri Balla dhe Rrugën "Enver Jaho".

2. Të miratojë Vendimin Nr.74, datë 06.06.2018 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektin aplikues **Z. Amlet Ngucaj (subjekti Z. Amlet Ngucaj me gjeneralitetet e subjektit sipas certifikatës së vitit 1991)** për një objekt banimi me sipërfaqe ndërtimi 31.0 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe truall funksional 157.0 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në Lagjen "24 Maji" të qytetit të Vlorës, zona kadastrale 8604, Nr. pasurie 7/127 që kufizohet nga Veriu me Fadil Rakipi dhe Rrugën "Prenjo Petoshati", Jugu me Esat Ngucaj, nga Lindja me pronë e të zotit dhe Lavdie Çerçizi dhe nga Perëndimi me Neki Ngucaj dhe Rrugën "Enver Jaho".



**Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me Nr. \_\_\_\_\_ Prot, datë \_\_\_\_\_ .2018**

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë  
Sheshi "4 Heronjtë", Vlorë  
Vlorë (AL)

Web site : [www.qarkuvlore.gov.al](http://www.qarkuvlore.gov.al)  
E-mail: [info@qarkuvlore.gov.al](mailto:info@qarkuvlore.gov.al)  
Tel: +355 33 421 608